



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 45 datë 28.05.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "SHITESË DHE
RIKONSTRUKSION NË OBJEKTIN EKZISTUES DHE NDËRTIM I RI OBJEKT
INDUSTRIAL, MAGAZINË, ZYRA, 1 DHE 5 KATE MBI TOKË, ME NDËRKAT
DHE ME 1-4 KATE NËNTOKË" ME VENDNDODHJE NË LUNDËR, BASHKIA
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive "Clima Experts" sh.p.k., "Klima Teknika TB2" sh.p.k. dhe Z.Theofilos Alimema, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Shtesë dhe rikonstruksion në objektin ekzistues dhe ndërtim i ri objekt industrial, magazinë, zyra, 1 dhe 5 kate mbi tokë, me ndërkate dhe me 1-4 kate nëntokë", me vendndodhje në Lundër, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë "Clima Experts" sh.p.k., "Klima teknika TB2" sh.p.k. dhe z.Theofilos Alimema.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
ENEA KARAKAÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 25/03 2026